



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

---Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. nr. 35/23**  
**38/23**

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Vedat Poterqoi - Kryetarë, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Kimete Gashi -Anetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik (GOE) "Bina sh.p.k& Delta - CCD sh.p.k" me seli në Vushtrri, si dhe ankesës së e Operatorit Ekonomik "N.T.P Bletaria Egzoni" me seli në Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me numra identifikues për bletë"-Ritender me nr. të prokurimit: 40800-20-8639-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit, me datë 13.04.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

1. **Aprovohet, si bazuar** ankesa e Grupit të Operatoreve Ekonomik ankues "Bina sh.p.k& Delta- CCD sh.p.k" me seli në Vushtrri, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 12.01.2023 me numër protokolli 35/2023, për aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me numra identifikues për bletë"-Ritender me nr. të prokurimit: 40800-20-8639-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit.
2. **Hedhet si e palejuar**, ankesa e Operatorit Ekonomik ankues N.T.P. "Bletaria Egzoni" & N.T.P. "Gresa Commerce" me seli në Gjakovë, e parashtruar në OSHP me datën 13.01.2023, me numër protokolli 38/23, për aktivitetin e prokurimit të sipër cituar.
2. **Anulohet**, Vendimi e AK-së i datës 30.12.2022, për anulim të aktivitetit të prokurimit "Furnizimi me numra identifikues për bletë" -Ritender me nr. të prokurimit: 40800-20-8639-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit, ndërkaq aktiviteti i prokurimit të sipër shënuar kthehet në **ri-vlerësim..**

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP-së për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.

4. OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/ L-068, dhe Ligjin 05/L-092.

5. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Bina sh.p.k & Delta- CCD sh.p.k”, i aprovohet si e bazuar, Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

6. Grupit të Operatoreve ekonomik ankues N.T.P. “Bletaria Egzoni” & N.T.P. “Gresa Commerce” me seli në Gjakovë, i bëhet kthimi i tarifës. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **A r s y e t i m**

#### *- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit, në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 30.12.2022, ka publikuar Vendimin e AK-së për anulim të aktivitetit të e prokurimit me titull: “Furnizimi me numra identifikues për bletë”-Ritender me nr. të prokurimit: 40800-20-8639-1-1-1.

Kërkesa për ri shqyrtim e GOE ankues “Bina sh.p.k& Delta- CCD sh.p.k” me datë 03.01.2023, si dhe vendimi për refuzim të kërkesës për ri shqyrtim nga AK: 06.01.2023

Kërkesa për ri shqyrtim e OE ankues “N.T.P Bletaria Egzoni”, me datë 04.01.2023, si dhe vendimi për refuzim të kërkesës për ri shqyrtim nga AK: 06.01.2023.

I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim, GOE “Bina sh.p.k& Delta- CCD sh.p.k” me datën 12.01.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP me numër të protokollit 035/23.

Po ashtu kundër vendimit të AK-së, për aktivitetin e prokurimit të sipër shënuar me datën 13.01.2023 ankesë në OSHP ka parashtruar edhe Operatori Ekonomik “N.T.P Bletaria Egzoni”, me numër të protokollit 38/23

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashkuar e kontratës: 670,000.00€.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 27 janar 2023 me raportin e ekspertizës. AK Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit me datë 30 janar 2023 ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Me datë 30 janar 2023 GOE “Bina sh.p.k& Delta- CCD sh.p.k”, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, po ashtu edhe OE “N.T.P Bletaria Egzoni”, me datë 31 janar ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave -*

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 27 janar 2023 ka rekomanduar që:

- Refuzohet si e pa bazuar ankesa e GOE “Bina sh.p.k& Delta- CCD sh.p.k”, me seli në Vushtrri,
- Të aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa OE “N.T.P Bletaria Egzoni”, me seli në Gjakovë,
- Të mbetet në fuqi vendimin e AK-së i datës 30.12.2022 dhe lënda të kthehet në ritenderim.

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lëndë, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesore me dt. 22.03.2023 me qëllim të vlerësimit të drejte të heshtjes si dhe pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete, raportin e vlerësimit të ofertave, raporti i ekspertës së jashtme shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron, se:

Lidhur me pretendimin e grupin e operatorëve ekonomik ankues “Bina” Sh.p.k. & “Delta – CCD” Sh.p.k. se AK me datën 30.12.2022 përmes sistemit të e-prokurimit jemi njoftuar se Agjencia e Veterinarisë dhe Ushqimit anulon këtë procedure të tenderit sepse nuk ka ofertues të suksesshëm, ku në këtë njoftimin nuk ka bashkangjitur letrat standarde të eliminimit, duke shkelur nenin 62 dhe të LPP-se dhe nenin 43 të RUOPP-se, si duke mos cekur as një arsye se perse grupi i OE “Bina” Sh.p.k. & “Delta – CCD” Sh.p.k. nuk mund të jete të suksesshëm kur ka plotësuar të gjitha kriteret të cilat janë kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, pasi që vlera e parashikuar e kontratës nga AK: Agjencia e Veterinarisë dhe Ushqimit, ka qene 670,000.00 euro, ndërsa grupi i OE “Bina” Sh.p.k. & “Delta – CCD” Sh.p.k., ka ofertuar në vlerë: 455,000.00 euro, që i bie se ka ofertuar brenda parashikimit të AK kontraktuese.

Paneli Shqyrtues sqaron se bazuar në raportet e komisionit të vlerësimit të cilat komisione të vlerësimit e kanë rekomanduar për kontratë disa herë radhazi, si dhe duke u bazuar në B58 të njoftimit mbi vendimin e AK të datës 30.12.2022, mirëpo nuk ka dhënë argumente pse nuk ka qenë oferta e suksesshëm, po ashtu nuk e ka marrë për bazë vendimin PSH nr. 196/21 të datës 30.03.2021 i cili vendim nuk obligon që ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se në bazë të nenit 43.2 të RRUOPP-së formulari B58 duhet të përmbajë vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe letrat standarde përkatës për tenderuesit me arsyetimet e nevojshme, si dhe ZPP në vendimin mbi refuzimin e kërkesës për

rishqyrtim te datës 06.01.2023 nuk ka sjelle asnjë prove se grupi i OE janë te papërgjegjshëm, por vetëm thirret ne vendim te OSHP dhe raportin e ekspertit e kur dihet qe vlerësimi i tenderëve sipas nenit 59 të LPP-së është përgjegjësi ekskluzive dhe ne diskrecion te AK – komisionit te vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave. Andaj Paneli Shqyrtues konsideron se AK nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, paragrafi 1 të LPP-së, pasi qe ky nen përcakton që *“autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminues dhe do të veproj në mënyrë transparente”*, si dhe neni 59 par. 4 të LPP-së, ku autoriteti kontraktues do te konsideroj një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruar ne njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit. Andaj ky aktivitet i prokurimit, është anuluar ne kundërshtim me paragrafët e nenit 62 të LPP-së, ku thuhet: 1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkeljeje të ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedure e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar ne pajtim me nenin 44.5 te RRUOPP-se, ku thuhet: “Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: (ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit te shkresave te lendes, raporti te ekspertes për këtë lëndë dhe diskutimit te palëve në seancën kryesore vjen në përfundim se autoriteti kontraktues me rastin e anulimi te këtij aktiviteti te prokurimit ka vepruar ne kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenit 44.5 të RRUOPP-së, pasi qe këto dispozita ligjore përcaktojnë se në cilat raste mund te anulohet aktiviteti i prokurimit dhe ne rastin konkret asnjë prej kushteve te parapara ne këto dispozite ligjore nuk është plotësuar. Andaj, obligohet autoriteti kontraktues që të bëjë ri-vlerësimin e ofertave ne pajtim te plote me kërkesat e përcaktuara ne dosje te tenderit dhe njëherit duke u bazuar në nenin 59 të LPP-së. Paneli më tej, vëren se në vendimet e AK dhe në Raportin e ekspertit shqyrtues nuk janë shpjeguar faktet me rendësi relevante lidhur me nenin 62 sepse secili pohim duhet vërtetuar me provë relevante e jo me citimin e dispozitave.

Lidhur me pretendimin e grupin e operatorëve ekonomik ankues N.T.P. “Bletaria Egzoni” & N.T.P. “Gresa Commerce” se AK me datën 30.12.2022 përmes sistemit te e-prokurimit jemi njoftuar se Agjencia e Veterinarisë dhe Ushqimit, anulon këtë procedure te tenderit sepse nuk ka ofertues te suksesshëm, ku në këtë njoftimin nuk ka bashkangjitur letrat standarde te eliminimit, duke shkelur nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RUOPP-së, si dhe se janë eliminuar nga aktiviteti prokurimit me arsyetimin se A-testet janë prezantuar ne gjuhen turke dhe qe sipas tyre këto A-teste janë prezantuar ne gjuhen turke pas një lëshimi teknik dhe qe te njëjtat sipas grupit te OE nuk janë specifikime teknike.

Lidhur me pretendimi e grupit te OE ankues N.T.P. “Bletaria Egzoni” & N.T.P. “Gresa Commerce”, për A-testes kjo çështje është konstatuar ne vendimin PSH.nr. 196/21 te datës 30.03.2021, ku është sqaruar se grupi i OE ka sjelle A-testet ne kundërshtim me nenin 13 të LPP-së dhe interpretimit të KRPP-së dhe sipas nenit 72 të LPP-së mund te kërkohe sqarime nga nenet 65-71 të LPP-së, si dhe ne baze te këtij vendimi ky OE ankues është i papergjeshem, andaj tani konsiderohet si pale pa interes konform nenit 4.1.26 te LPP.

Paneli Shqyrtues konsideron se lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, grupi i OE ankues nuk ka arritur te dëshmoj, bind Panelin Shqyrtues se i njëjti është tenderues i përgjegjshëm me çmimin me te ulet, sikurse parashihet me nenin 60 të LPP-së, andaj mbi bazën e te lartcekurave, konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së. Paneli shqyrtues konstatimet e tij i bazon kryesisht në dispozite relevantet e LPP-së, te cilat parashohin dhe rregullojnë situatat e tilla, te cilat mund te paraqiten gjatë një aktiviteti te prokurimit sikurse ankesa nga grupi i OE ne këtë rast. Vendimin e PSH.nr.196/21, duke marr për bazë dispozitat ligjore të LPP-së, dihet mire se vendimet e OSHP-se janë te detyrueshme për autoritetin kontraktues dhe te gjitha palët në procedurë dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund te ankohen ne gjykate kompetente brenda afatit ligjore me mjete te rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë ne këtë vendim. Me ç'rast ankuesi kundër këtij vendimi 196/21 nuk e ka ofruar prova se e ka atakuar në gjykatën kompetente, ndërsa ky vendim pas kalimit të afatit ligjor prej 30 ditëve konsiderohet i plotfuqishëm.

*- Përfundim -*

Në këtë rast, në kontekstin e natyrës së kësaj lënde, Paneli shpjegon po ashtu se sistemi i prokurimit publik duhet ti përmirësoj në çdo aspekt kapacitetet profesionale dhe të përgatitet për proceset e integritetit sepse praktikat e mira dhe standardet e prokurimit ndërkombëtar nuk e pranojnë anulimin e një aktivitetit të prokurimit në çdo fazë dhe për çfarëdo arsyeje.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, por se mbetet në detyrimin eksplisit të këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Paneli niset nga fakti se shqyrtimi administrativ i ankimimit duhet të garantojë si uniformitetin e veprimtarisë së prokurimit dhe sigurinë juridike dhe të promovoj besimin në publik përmes një procesi të rregullt ligjor. Mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për Panelin Shqyrtues, në cilin do versionet e tij dhe për më tepër i njëjtë nuk i fiton tiparet e provës gjithnjë përderisa të jetë i kontestuar nga cila do palë në procesin e prokurimit publik, aq më tepër kur eksperti shqyrtues nuk i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore për të cilat ka qenë përgjegjës, këtë e vërteton edhe raporti i ekspertizës por edhe vetë eksperti në seancën e mbajtur dhe për këtë ka pasur mos pajtueshmëri nga palët, po ashtu nuk është bërë vlerësimi i provave dhe i shkresave në tërësi për këtë aktivitet. Prandaj në këtë rast Paneli ka shprehur mendimin e pavarur të tij kurse vlera provuese një raporti jepet me vlerësimin dhe krahasimin me të gjitha provat e tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Në këtë rast, OSHP pret që AK të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim.

Vendimi sikurse në pikën 5, të dispozitivit është marrë ne kuptim te nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores se punës se Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Vendimi sikurse në pikën 6, të dispozitivit është marrë ne kuptim se njoftimi për OE i publikuar në ueb faqen e OSHP, sa i përket konfiskimit të tarifës së ankesës në këto raste të ngjashme të trajtimit të “palës pa interes“ është bërë pasi që është parashtruar ankesa në OSHP.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi



**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit

1x1 OE-ve ankese.

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.